GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 3824/16

EDMOND ZHUPA KUNDËR SHQIPËRISË
(Shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 7 tetor 2021, si Komision i përbërë nga:

Dmitry Dedov, *kryetar,*

Peeter Roosma,

Andreas Zünd, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit,*

Pasi morën në konsideratë kërkesën e paraqitur më 11 janar 2016,

Duke marrë në konsideratë parashtrimin e paraqitur nga Qeveria e paditur, e cila i kërkon Gjykatës të përjashtojë kërkesën nga lista e çështjeve dhe përgjigjen e kërkuesit si përgjigje ndaj këtij parashtrimi,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkuesit paraqiten në tabelën bashkëngjitur.

Ankesat e kërkuesit sipas nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedimeve civile, iu komunikuan Qeverisë së Shqipërisë ("Qeveria").

Qeveria parashtroi një deklaratë me fokus zgjidhjen e problematikave të ngritura nga këto ankesa. Në vijim, Qeveria i kërkoi Gjykatës të përjashtonte kërkesën.

Në deklaratë, Qeveria pranonte kohëzgjatjen e tepërt të procedimeve civile të ndërprera. Qeveria parashtroi se në nëntor 2017 kishte hyrë në fuqi një mjet i ri parandalues dhe detyrues në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve. Qeveria ofronte t'i paguante kërkuesit shumën e detajuar në tabelën bashkëlidhur dhe e ftonte Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve, sipas nenit 37§1 (c) të Konventës. Shuma do të konvertohej në vlerën monetare të Shtetit të Paditur, në normën e aplikueshme në datën e pagesës, dhe do të paguhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mospagesës së kësaj shume brenda periudhës së sipërpërmendur tremujore, Qeveria ndërmerrte të paguante interesin e thjeshtë mbi shumën, që nga përfundimi i periudhës deri në pagesën e saj të plotë, në një normë të barabartë me normën huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës kur shuma nuk është paguar, plus tre pikë përqindje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkuesi informoi Gjykatën se binte dakord me kushtet e deklaratës.

LIGJI

Gjykata konstaton se, pas dakordësimit të shprehur të kërkuesit, për kushtet e parashtrimit të bërë nga Qeveria, çështja duhet të trajtohet si një zgjidhje miqësore midis palëve.

Për këtë arsye, Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo gjykon se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas përkufizimit të Konventës dhe Protokolleve të saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për shqyrtimin e justifikuar të kërkesës.

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime:
Vendos ta heqë kërkesën nga lista e saj e çështjeve sipas nenit 39 të Konventës.
Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 28 tetor 2021.

Viktoriya Maradudina — ZËVENDËSREGJISTRARE E PËRKOHSHME

Dmitry Dedov — KRYETAR

SHTOJCË
KËRKESË E CILA PARASHTRON ANKESA SIPAS NENIT 6§1 TË KONVENTËS

(Kohëzgjatje e tepruar e procedimeve civile)

Kërkesa nr. data e paraqitjes	**Emri i kërkuesit Viti i lindjes**	**Data e marrjes së deklaratave të Qeverisë**	**Data e marrjes së dakordësimit të kërkuesit**	**Shuma e dhënë për dëmin jomonetar dhe kostot, dhe shpenzimet për kërkues[1]**
3824/16 11.1.2016	**Edmond ZHUPA** 1958	2/7/2021	7.9.2021	2.300

[1] Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.